



Prishtinë, 20 gusht 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1022_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, 15, dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 22 paragrafi 5 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Kërkesën e KOSTT në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të datës 15.08.2018 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit *Procedura për tregtimin e energjisë elektrike*;

në seancën e mbajtur me datë 20 gusht 2018, nxori këtë:

VENDIM

I. MIRATOHET dokumenti *Procedura për tregtimin e energjisë elektrike*

Arsyetim

- 1) Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 15 gusht 2018 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit *Procedura për tregtimin e energjisë elektrike* nga KOSTT Sh.A. Dokumenti është zhvilluar nga KOSTT duke u bazuar në Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
 - 2) Gjatë zhvillimit të dokumentit janë konsultuar edhe ndërmarrjet tjera energjetike si KEK, KESCO, KEDS dhe Ujmani të cilët kanë kontribuar me komentet e tyre.
 - 3) Po ashtu ZRRE ka qenë e angazhuar në përgatitjen e dokumentit gjatë tërë kohës dhe ka bërë komente dhe sugjerime për çështje substanciale të dokumentit.
 - 4) Bazuar në Nenin 22 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Bordi i ZRRE-së pas analizimit të dokumentit përfundimtar konsideron se dokumenti i përmbush kriteret për miratim, dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke miratuar dokumentin *Procedura për tregtimin e energjisë elektrike*.
- II. *Procedura për tregtimin e energjisë elektrike* do të publikohet në faqen zyrtare të ZRRE-së.
- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:
Procedura për tregtimin e energjisë elektrike.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së,

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar
Selman Hoti, anëtar
Izet Rushiti, anëtar